

Sa shpejt pas terapisë shfaqet përmirësimi?

Kruajtja është pasojë e një reagimi alergjik ndaj marimangës së zgjebes dhe produkteve të saj, prandaj do të jetë e pranishme për të paktën 2-3 javë, derisa lëkura të largojë gjithçka.

Kjo nuk do të thotë që trajtimi nuk ka qenë i suksesshëm!

Nëse kruajtja është shumë e pakëndshme, mjeku mund të përshkruajë një mjet kundër kruajtjes.

Pas një terapie të suksesshme, në 24-48 orët e ardhshme nuk duhet të shfaqen gërvishtje të reja, apo ndryshime të tjera në lëkurë.

Nëse kruajtja vazhdon pas tre javësh, konsultohuni përsëri me mjekun tuaj.

Literatura :

Website : [http:// www.hpa-nw.org.uk/](http://www.hpa-nw.org.uk/)

Cambridgeshire & Peterborough Scabies Guidance

Burimi i informacionit : <http://www.lib.uiowa.edu/hardin/md/dermnet/scabies.html>

ZGJEBJA(SCABIES)

Shkurt 2015

Çfarë është zgjebja?

Zgjebja ose kruarja është një sëmundje ngjitëse e lëkurës e shkaktuar nga një marimangë e quajtur *Sarcoptes scabiei*. Femra e rritur hap tunel nën shtresën sipërfaqësore të lëkurës dhe vendos aty vezët. Ajo është më aktive natën, kur lëkura ngrohet, ndaj kruarja është më e fortë gjatë natës.

Tek ata që infektohen për herë të parë, ndryshimet në lëkurë dhe kruarja shfaqen pas 4-6 javësh nga infektimi.

Ndryshimet në lëkurë gjenden kryesisht në vendet ku lëkura është e butë dhe e hollë (midis gishtave, brenda kyçeve, bërrylat, gjunjët, rreth kërthizës...).

Ndryshimet në lëkurë janë të dukshme si puçrra rozë, të madhësisë së një kokrrë gruri, shpesh me kore në majë. Ata zakonisht shfaqen në dyra dhe dyra, që përfaqësojnë fillimin dhe fundin e tunelit. Për shkak të kruarjes, mund të shfaqen gërvishitje, fluska të vogla dhe skuqje. Ndryshimet janë zakonisht simetrike në pjesët e jashtme të trupit dhe nuk shfaqen në qendrën e gjoksit apo shpinës.

(Më të zakonshmet vende ku gjenden ndryshimet në lëkurë te burrat dhe gratë - simetrikisht)

SI INFEKTOHEMI?

Infektohemi kryesisht përmes kontakteve të ngushta trup më trup (lëkurë-lëkurë), si për shembull:

- **Mbajtja për dore për një kohë të gjatë**
- **Fjetja në të njëjtin shtrat**
- **Marrëdhënia seksuale me një person të infektuar.**

Kontaktet e rastësishme, si shtrëngimi i duarve ose përqaftimi, zakonisht nuk mjaftojnë për të shkaktuar infektim.

Infektimi indirekt përmes përdorimit të rrobave, peshqirëve ose çarçafëve të një personi të infektuar është më i rrallë.

Zgjebje nuk kërcëjnë apo fluturojnë, por zvarriten mbi lëkurën e ngrohtë me shpejtësi prej 2,5 cm/minutë. Në mjedise të jashtme mund të mbijetojnë 24-36 orë në temperaturë ambienti dhe lagështi mesatare.

Zgjebja nuk është shkaktuar nga higjiena e dobët.

Infektimi përhapet shpejt në vende ku kontaktet e ngushta lëkurë më lëkurë janë të shpeshta (spitale, kopshte, shkolla, qendra kujdesi...).

KUSH MUND TË INFEKTOHET?

Garja mund të prekë ÇDOKËND që ka pasur kontakt të ngushtë me një person të infektuar nga marimanga e zgjebjes.

Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që të trajtohen njëkohësisht të gjithë anëtarët e familjes dhe kontaktet e ngushta (shokët e klasës, edukatorët), edhe nëse nuk shfaqin kuarje ose skuqje.

Zgjebja është e përhapur në të gjithë botën dhe çdo person mund të infektohet.

TRAJTIMI I KRUARJES (ZGJEBJES)

Për një trajtim të suksesshëm, është shumë e rëndësishme të ndiqni udhëzimet e mjekut dhe ato të prodhuesit të ilaçit.

Si të aplikoni kremi ose pomadën:

Aplikojeni gjithmonë në lëkurë të ftohtë dhe të thatë, kurrë menjëherë pas një banje të ngrohtë.

Përhapeni pomadën në të gjithë trupin, nga koka deri te këmbët.

Sigurohuni që pomada të mos hyjë në sy ose gojë.

Nëse pas aplikimit lani duart ose ndonjë pjesë tjetër të trupit, duhet të aplikoni pomadën përsëri në ato zona.

Lëreni kremi ose pomadën në lëkurë për 8-24 orë, në varësi të udhëzimeve për ilaçin.

Pas kësaj kohe, shpëlajeni fillimisht me ujë të ftohtë dhe më pas me sapun dhe ujë të ngrohtë.

Lani rrobat dhe çarçafët në lavatriçe si zakonisht.

Trajtimi duhet të përsëritet pas një jave.

Në të njëjtën kohë, duhet të aplikojnë kremi ose pomadën të gjithë anëtarët e familjes që jetojnë në të njëjtën shtëpi apo apartament, si dhe të gjithë ata që kanë pasur kontakt lëkurë më lëkurë ose marrëdhënie seksuale me personin e infektuar.

E rëndësishme:

- Informoni të gjithë kontaktet e ngushta që keni zgjebje.
- Mos e fshehni këtë informacion! Transparenca ndihmon në parandalimin e përhapjes së infeksionit.